

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 25. 09. 2017

Lënda: Kriteret për pranimit e pedagogëve të ftuar në Departamentin e Urbanistikës për vitin akademik 2017 - 2018.

V E N D I M

Departamenti i Urbanistikës i propozon Dekanatit të Fakultetit të FAU kriteret e pranimit të pedagogëve të ftuar:

Kriteret për pranim të stafit akademik të ftuar:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e plota universitare brenda ose jashtë vendit. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS.
2. Të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalente me te) në *profilin* Urbanistikë / Arkitekture, ose një profil të përputhshëm me lëndën në të cilën do të japë mësim, ku nota mesatare do të jetë mbi 7.5. Preferohet mesatarja e lëndëve të specialitetit mbi 9.
3. Preferohen kandidatet të zotërojë gradën DOKTOR ose te jete ne proces te mbrojtjes se Doktoraturës ne fushën e Urbanistikës ose të Arkitekturës.
4. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore e mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi. (preferohen gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht).
5. Preferohen kandidatet që kanë kryer kurse. kualifikime etj, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës .

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për stafin akademik të ftuar:

1. Kërkesë te vecantë me shkrim për seicilen lëndë ku kërkon të konkurojë (jo më shume se pesë lëndë – kërkesat pa lëndë të specifikuara, nuk shqyrtohen nga komisioni).
2. Dokument identifikimi (kopje e noteruar).
3. C. V të përgjithshme të përqendruar.
4. Diploma dhe të lista e notave (kopje e noteruar).
5. Dëshmi te gjuhëve të huaja që zotëron.
6. Provime pasuniversitare, mikroteza etj.
7. Botime (monografi, artikuj, tekste mësimore, projekte).
8. Kualifikime brenda ose jashtë vendit.
9. Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.
10. Raport mjeko-ligjor.
11. Dy letra referencash.

Shënim: Dorëzimi i dokumentacionit nga kandidatet, do të kryhet pranë Zyres së Departamentit te Urbanistikës, (FAU) deri në datën 10.10.2017.

Vlerësimi i kandidatëve për stafin akademik të ftuar:

Komisioni i vlerësimit, përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë: përgjegjësi i departamentit, drejtuesi i lëndës, mesimdhënës lëndës (apo të lëndëve të ngjashme).

- Vlerësimi i permajtjes të dosjes së dorëzuar nga konkurenti (60 %)
- Vlerësimi i konkurentit nëpërmjet një interviste në komisionin e vlerësimit (40%)

Në përfundim të procesit, komisioni liston kandidatët në rend zbritës, dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mesimdhënie në lëndën përkatëse.

Lendët ku konkurohet për stafin akademik të ftuar:

KURSI	DEGA	LENDA
VITI 2	A+U	Urbanistike 1
VITI 4	A+U	Sistemim Gjelberim
	Mjedisi	Planifikim Urban, DPT Mjedisi
VITI 4	A	Urbanistika 2
	A+U	Histori Urbanistike + Sociologji(me zgjedhje)
	U	Planifikim Territorial
	U	Histori Urbanistike
	U	Legjislacion Arkitektonik e Urban
	U	Ekonomi Tregu + Ekonomi Urbane
	U	Gjeografi Urbane
	U	Sociologji Urbane
	Mjedisi	Planifikim Urban, DPT Mjedisi
VITI 5	U	Elemente peisazhi
	U	Menaxhim Urban
	U	Politikat e Strehimit
	U	G.I.S

PERGJEGJESI I DEPARTAMENTIT TE URBANISTIKES

Prof. Asoc. Armand VOKSHI